



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .02.2024

**MBLEDHJA Nr. 4,
Datë 19.02.2024, ora 09:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e hënë, datë 19.02.2024, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 4 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalve të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 29.01.2024 dhe datë 06.02.2024.
2. Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive, Tren Sun System sh.p.k., Sun Beat System sh.p.k., NTSP sh.p.k., Korca Photovoltaic Park sh.p.k. dhe shoqërive Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Protergia Energy Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Arsti” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Arsti”.
6. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë

se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI